



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

01Nr.04-610/01-12903/22  
Kaçanik, 31.05.2022

Në bazë të nenit 11 dhe 12. 2(c) lidhur me nenin 17 (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/4 Qershor 2008), të nenit 2 pika 2.1 lidhur me nenet, 4,5,6 dhe 7 të Ligjit Nr.04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (Gazeta Zyrtare Nr. 7/26 Mars 2013), të Propozim Vendimit të Drejtorisë së Arsimit 04-610/01-12903/22 (bashkëngjitur), Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 31 Maj 2022, mori këtë:

#### V E N D I M

#### **PËR NDRYSHIMIN E THIRRJES, SHKOLLA E MESME PROFESIONALE – SHMP “FERIZ GURI DHE VËLLEZËRIT ÇAKA”, NË INSTITUCION I ARSIMIT DHE AFTËSIMIT PROFESIONAL - IAAP “FERIZ GURI DHE VËLLEZËRIT ÇAKA”**

1. Me këtë vendim, Shkolla e Mesme Profesionale – SHMP “ Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka” do të thirret: **Institucion i Arsimit dhe Aftësimit Profesional – IAAP “ Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”**.
2. Ndryshimi i thirrjes së institucionit arsimor nga pika 1. e këtij vendimi, bëhet me qëllim të rregullimit, strukturimit, organizimit dhe menaxhimit të institucionit i cili ofron arsim dhe aftësim profesional dhe në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional.
3. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në MAPL dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria e Arsimit.

#### **Me këtë vendim njoftohen:**

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria e Arsimit (përmes kësaj drejtorie njoftohen mekanizmat tjerë relevantë);
3. Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Murseti



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë  
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije  
Ministri of Education, Science and Technology

Data: 08.05.2009  
Nr. 421/04-B  
Prishtinë

Në bazë të nenit 93.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë nr.2002, neni 42.1, Udhëzimit Administrativ 10/2008, Vendimit për themelim Nr.01/02 të hyrë në fuqi me dt. 17.01.2002, Komisioni për emërtimin dhe riemërtimin e shkollave pranë Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë merr:

**V E N D I M**

- Shkolla e mesme profesionale në Kaçanik emërtohet “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”
- Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij

**Arsyetim**

Në bazë të dispozitave të lartpërmendura, Komisioni për emërtimin dhe riemërtimin e shkollave në MASHT në mbledhjen e mbajtur më 04.05.2009 shqyrtoi kërkesën e Këshillit të shkollës së mesme profesionale në Kaçanik për emërtimin e shkollës. Komisioni konstatoi se lënda ka kaluar nëpër procedurë të rregullt. Nga tre emra të merituar, prioritet i është dhënë emrit “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”. DKA-ja në Kaçanik si dhe Komisioni i MASHT-it kanë përkrahur propozimin që shkolla e mesme profesionale në Kaçanik të emërtohet “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”. Duke u mbështetur në këto argumente u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Udhëzime juridike**

Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh në Komisionin për ankesa dhe parashtrësia pranë MASHT-it.

**Vendimi i dorëzohet**


- 1 Drejtorisë Komunale të Arsimit në Kaçanik
2. Shkolla e mesme profesionale “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka” në Kaçanik
3. Arkivit në MASHT



**Enver Hoxhaj, ministër**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Arsimit  
04 Nr 610/01-12903/22  
Kaçanik, 13.05.2022

Bazuar në Neni 2, pika 1.2. të Ligjit Nr.04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional i cili rregullon sistemin e arsimit dhe aftësimit profesional, dhe në pajtim me dispozitat e këtij ligji, Drejtoria e Arsimit bënë këtë :

#### PROPOZIM

Që Kuvendi i Komunës të merr këtë:

#### VENDIM

1. Shkolla e Mesme Profesionale, ShMP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" të thirret Institucion i Arsimit dhe Aftësimit Profesional, IAAP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka"
2. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria e Arsimit
3. Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyren e protokollit në MAPL dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

#### Arsyetim

Drejtoria e Arsimit me qëllim të rregullimit, strukturimit, organizimit dhe menaxhimit të institucionit i cili ofron arsim dhe aftësim profesional dhe në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, ka bërë Propozim - Vendimin që Institucioni arsimor që ofron arsim dhe aftësim profesional të thirret: IAAP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka". Bashkangjitur me propozimin është edhe vendimi për emërtim i cili do të mbetet i njejtë vetëm thirrja do të ndryshojë nga ShMP në IAAP në përputhje me ligjin në fjalë.



Drejtor i Arsimit  
Zahir Doda